



WORLD BANK GROUP

BALLKANI PERËNDIMOR RAPORT I RREGULLT EKONOMIK
Nr.19 | Pranverë 2021

SHQIPËRIA

RIMËKËMBJE E VËSHTIRË | RAPORT PËR VENDIN



© 2021 International Bank for Reconstruction and Development / The World Bank
1818 H Street NW
Washington DC 20433
Telephone: 202-473-1000
Internet: www.worldbank.org

Ky raport është produkt i stafit të Bankës Botërore me kontribute të jashtme. Gjetjet, interpretimet, dhe përfundimet e shprehura në këtë raport nuk reflektojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Bankës Botërore, Bordit të Drejtorëve Ekzekutivë të Bankës Botërore, ose të qeverive që ata përfaqësojnë.

Banka Botërore nuk garanton saktësinë e të dhënave të përfshira në këtë raport. Kufijtë, ngjyrat, përcaktimet ose informacionet e tjera që përmban secila prej hartave në këtë dokument nuk nënkuptojnë asnjë interpretim nga ana e Bankës Botërore lidhur me statusin ligjor të ndonjë territori, ose miratimin apo pranimin e këtyre kufijve.

Të Drejtat dhe Lejet

Materiali në këtë raport është i mbrojtur nga e drejta e autorit. Meqënëse Banka Botërore nxit publikimin e punës së saj, ky raport mund të riprodhohet, i plotë ose pjesërisht, për qëllime jokomerciale me kusht që asaj t'i atribuohen të gjitha të drejtat për këtë raport. Të gjitha pyetjet lidhur me të drejtat dhe licencat, përfshirë të drejtat e riprodhimit, duhet të drejtohen në: World Bank Publications, The World Bank Group, 1818 H Street NW, Washington, DC 20433, USA; fax: 202-522-2625; e-mail: pubrights@worldbank.org.

Shqipëria

- Shqipëria u godit rëndë, fillimisht nga tërmeti i Nëntorit 2019 dhe më pas nga pandemia COVID-19.
- Me tkurrjen e shpejtë të turizmit dhe shërbimeve, PBB-ja u zvogëlua me rreth 3.3 përqind.
- Rindërtimi dhe stimujt e lidhur me COVID-19 ndikuan në zbutjen e tronditjeve, por hapësira fiskale u ngushtua.
- Rindërtimi pritet të jetë shtylla kryesore e rimëkëmbjes ekonomike në vitin 2021, duke u ndihmuar nga një rritje e lehtë e kërkesës private për shkak të kufizimeve të vazhdueshme në udhëtim.

Zhvillimet e Fundit Ekonomike

Rritja ekonomike u tkurr me 3.3 përqind në vitin 2020. Pandemia COVID-19 i shkaktoi një dëm të madh një ekonomie tashmë të shkatërruar nga tërmeti i vitit 2019. Megjithatë, tronditja ndaj themeleve të ekonomisë dhe rritjes ekonomike ishte dukshëm më e vogël nga sa u mendua fillimisht. Mbyllja e sektorëve kyç në tremujorin e dytë (T2) shkaktoi një rënie të madhe të ekonomisë me 10.6 përqind. Sektorët e parë që u goditën nga pandemia ishin udhëtimi dhe turizmi, dhe kufizimet zyrtare së bashku me ndryshimin e sjelljes pas COVID ndikuan si në ofertë ashtu edhe në kërkesë. Duke pasur parasysh strukturën e ekonomisë, rënia e shitjeve, dhe fitimeve, pati një efekt disproporcional mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Në verë, me heqjen e masave të distancimit social, aktiviteti ekonomik filloi rimëkëmbjen dhe turistët vendas kompensuan pjesërisht rënie drastike të turistëve të huaj. Ndërsa në T3 rënia ekonomike ishte 2.8 përqind, procesi i rindërtimit pas tërmetit ndikoi në zvogëlimin e efekteve të pandemisë; në T4 rritja e ndërtimit çoi në një rritje ekonomike prej 3 përqind (v-m-v).

Konsumi privat dhe vendimet për investime u shtynë për shkak të pasigurisë në lidhje me përfundimin e krizës dhe rritjes së numrit të infektiveve në mënyrë

graduale gjatë vitit. Investimet u tkurrën me 1.8 përqind në vitin 2020, ndërsa konsumi privat ra me 2.4 përqind¹. Ulja e numrit të porositjeve për prodhimin e veshjeve çoi në një rënie të eksportit të mallrave prej 6.7 përqind, ndërsa vizitat turistike ranë me 60 përqind. Kontributi i eksporteve neto në rritjen ekonomike ishte pozitiv me 0.5 pikë përqindjeje (pp), për shkak se importet u tkurrën më shumë sesa eksportet në përgjigje të rënies së kërkesës private.

Pavarësisht problemeve strukturore, treguesit e tregut të punës u korrigjuan relativisht shpejt me rihapjen e ekonomisë pas mbylljes fillestare. Në verë, punësimi nisi të rikuperohej për shkak se një pjesë e humbjeve të vendeve të punës në sektorin e prodhimit u thithën nga sektorët e turizmit dhe ndërtimit.

Rritja e shpenzimeve sociale dhe rindërtimi pas tërmetit zbutën ndikimin e pandemisë në varfëri. Disa nga masat e prezantuara nga autoritetet shqiptare ishin subvencionimi i pagave, rritja e shpenzimeve për përkrahje sociale dhe miratimi i dy garancive shtetërore për kreditë e dhëna nga bankat e nivelit të dytë për të lehtësuar pagesat e pagave dhe për të siguruar fondet e nevojshme për kapital qarkullues dhe investime për bizneset. Shpenzimet publike u rritën në 33.2 përqind të

¹ Nuk përfshin mospërputhjen statistikore.

PBB-së. Për t'iu ardhur në ndihmë ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, qeveria miratoi shtyrjen afatit të pagesës së taksave dhe përjashtime të reja nga TVSH-ja. Të ardhurat totale publike ranë në 26.5 përqind të PBB-së, pavarësisht granteve për financimin e rindërtimit. Rritja e deficitit fiskal dhe zgjatja e garancive shtetërore post-COVID për sektorin privat bëri që borxhi publik të rritej në 77.4 përqind të PBB-së. Ndonëse rregulli fiskal përmban detyrimin për uljen e përvitshme të borxhit në raport me PBB-në derisa ai të arrijë në 45 përqind të PBB-së, borxhi i Shqipërisë u rrit për herë të parë që nga viti 2017. Rregulli fiskal përfshin një klauzolë për rrethanat e jashtëzakonshme, e cila u aplikua në 2020.

Inflacioni ka qëndruar nën kufirin e synuar, megjithëse pas izolimit ai filloi të reflektojë kosto më të larta në transport dhe prodhim.

Inflacioni mesatar arriti 1.6 përqind në vitin 2020, kryesisht për shkak të ndërprerjeve në zinxhirin e furnizimit gjatë periudhës së izolimit. Kontribuesi më i madh në inflacion kanë qenë çmimet e ushqimeve. Megjithatë, me heqjen e disa masave kufizuese në maj, këto efekte filluan të zbuten.

Me një inflacion në nivele të ulëta, politika monetare ishte akomoduese: Banka e Shqipërisë (BSH) uli normën e politikës monetare dhe injektoi likuiditet në sistemin bankar. Si kundërpërgjigje ndaj goditjes së COVID-19 në ekonomi, BSH uli sërish normën bazë të interesit me 50 pikë bazë, duke arritur një minimum të ri historik prej 0.5 përqind. Përveç kësaj, ajo hoqi tavanin për kreditë afatshkurtra nga banka qendrore me qëllim mbështetjen e amortizatorëve të likuiditetit në sistemin bankar. Gjithashtu u prezantuan instrumente makroprudenciale, të tilla si zvogëlimi i kërkesës së kapitalit për letrat me vlerë të qeverisë në valutë të huaj, me qëllimin për të ndihmuar bankat të financojnë huamarrjen e qeverisë në valutë të huaj; pasi në tregun e brendshëm ka likuiditet të bollshëm në valutë të huaj.

Kursi i këmbimit vijon të jetë fleksibël, gjë e cila i jep mundësi Shqipërisë të asimilojë goditjet e jashtme. Deri në fund të vitit 2020, monedha vendase ishte mbiçmuar me 1.3 përqind ndaj euros. Sektori bankar, i cili është i mirëkapitalizuar dhe likuid, ka ndihmuar në amortizimin e efekteve të krizës. Kredia për sektorin privat u rrit me 6.7 përqind në fund të 2020, mbështetur nga skemat e garantimit të kredive lidhur me situatën COVID dhe kostot e ulëta të financimit. Në përgjigje të pandemisë, BSH ndërmori masa të tilla lehtësuese si moratoriumet, ristrukturimi dhe klasifikimi i kredive, disa prej të cilave do të vazhdojnë deri në pranverën e vitit 2021. Efektet e krizës mbi cilësinë e portofolit të kredive pritet të qartësohen edhe më shumë në gjysmën e dytë të vitit 2021, me një rritje të mundshme të kredive me probleme.

Deficiti i llogarisë korrente u rrit në 8.9 përqind të PBB-së në vitin 2020 ndërsa deficiti tregtar në terma nominalë u zgjerua. Remitancat vijuan të hyjnë në vend, pavarësisht krizës në vendet e BE-së ku jetojnë emigrantët. Pakësimi i fluksit të turistëve, ulja e porosive të përpunimit të tekstileve si dhe ulja e çmimeve të naftës çoi në rënie të eksporteve me 28.6 përqind në terma vjetorë. Investimet e huaja direkte (IHD) dhe huamarrja e qeverisë në nivele të konsiderueshme, përfshirë financimet komerciale dhe nga institucionet financiare ndërkombëtare, financuan llogarinë korrente ndërsa IHD-të ranë në 6.9 përqind të PBB-së.

Perspektiva Ekonomike dhe Rreziqet

Në rast se do të duhen disa vite deri në përfundim të procesit të vaksinimit në të gjithë botën, ka të ngjarë që turizmi dhe udhëtimet të mbeten të kufizuara. Në këtë rast, PBB-ja në vitin 2021 do të rritet me rreth 4.4 përqind si rezultat i rimëkëmbjes së eksporteve, konsumit dhe investimeve. Sektori i shërbimeve, i udhëhequr nga turizmi, dhe ndërtimi pritet të jenë nxitësit kryesor të


rimëkëmbjes, pjesërisht falë investimeve në procesin e rindërtimit, siç ka ndodhur pas katastrofave të ngjashme natyrore në ekonomitë në zhvillim. Në vitet e ardhshme, rritja do të varet gjithnjë e më shumë nga konsumi privat, duke mbështetur përpjekjet e rindërtimit. Investimet private do të kontribuojnë në rritje për sa kohë që qeveria do të vijojë reformat për përmirësimin e klimës së biznesit dhe do të rritet aksesin e biznesit në financa. Pas vitit 2021, hapësira e kufizuar fiskale ka të ngjarë të çojë në pakësim të shpenzimeve qeveritare. Situata fiskale mund të përkeqësohet nëse mbledhja e të ardhurave nuk rritet. Në këtë rast, qeverisë mund t'i duhet të ulë shpenzimet kapitale për të mbajtur nën kontroll raportin e borxhit ndaj PBB-së.

Deficiti i llogarisë korrente pritet të ngushtohet në 7.7 përqind të PBB-së në 2021 duke u ulur më tej në 6.4 përqind, në

linjë me trendin e periudhës para krizës dhe nxitur nga përmirësimet e parashikuara në bilancin tregtar. Eksportet e shërbimeve, veçanërisht turizmi dhe operacionet e procesit të biznesit me zgjerim të shpejtë, duhet të çojnë në ngushtim të deficitit tregtar në periudhë afatmesme. Rritja e importit në 2021 do të jetë e lartë në 15,8 përqind si rezultat i përshpejtimit të investimeve në infrastrukturë.


Me rigjallërimin e aktivitetit ekonomik, të ardhurat parashikohet të rriten në 27.6 përqind të PBB-së gjatë periudhës 2021-22. Në 2021, parashikohet një ulje e lehtë e borxhit publik të Shqipërisë, në 77.3 përqind të PBB-së. Perspektiva e punësimit varet së tepërmi nga rimëkëmbja e sektorëve të shërbimeve dhe nga rindërtimi, ku vendet e punës janë kryesisht me pagë të ulët dhe të ekspozuar ndaj pasigurisë ekonomike.

Pandemia Covid19 dhe tërmeti goditën rëndë ekonominë.




Burimi: INSTAT dhe përllogaritje të stafit të Bankës Botërore.

Stimujt e fortë fiskalë ndihmuan personat e cënueshëm—por me pasojë rritjen e borxhit publik.




Burimi: INSTAT, MFE dhe përllogaritje të stafit të Bankës Botërore.

Instrumentat e garancisë u përdorën për të stimuluar rritjen e kreditimit.




Burimi: BSH dhe përllogaritje të stafit të Bankës Botërore.

Por efekti në tregun e punës ishte më pak i ashpër.




Burimi: INSTAT.

Inflacioni ra poshtë intervalit së synuar prej 2-4 përqind.



Burimi: BSH dhe përllogaritje të stafit të Bankës Botërore.

Deficiti më i lartë korrent u financua nëpërmjet huamarrjes së qeverisë.



Burimi: BSH dhe përllogaritje të stafit të Bankës Botërore.

SHQIPËRIA	2017	2018	2019	2020v	2021p	2022p
Rritja e PBB-së reale (në përqindje)	3.8	4.1	2.2	-3.3	4.4	3.7
Përbërja (pikë përqindje):						
Konsumi	2.1	3.1	2.5	-3.0	2.8	2.5
Investimet	1.5	0.7	-0.9	-0.7	1.2	-1.1
Eksportet neto	0.2	0.2	0.6	0.5	0.4	2.2
Eksportet	4.1	1.4	2.0	-8.9	5.2	4.0
Importet (-)	3.8	1.1	1.4	-9.4	4.8	1.8
Inflacioni i çmimeve të konsumit (në përqindje, mesatare e periudhës)	2.0	2.1	1.4	1.6	2.4	2.8
Të ardhura publike (përqind e PBB-së)	27.8	27.5	27.4	26.5	27.8	27.4
Shpenzimet publike (përqind e PBB-së)	29.8	29.2	29.4	33.2	33.3	31.4
Prej të cilave						
Shpenzime për paga (përqind e PBB-së)	4.7	4.5	4.6	4.8	4.9	4.7
Asistencë sociale (përqind e PBB-së)	12.0	11.6	11.9	13.7	13.0	12.3
Shpenzime kapitale (përqind e PBB-së)	4.4	4.8	4.5	6.3	6.6	4.6
Bilanci fiskal (përqind e PBB-së)	-2.0	-1.7	-2.0	-6.7	-5.4	-4.0
Bilanci primar fiskal (përqind e PBB-së)	0.0	0.5	0.1	-4.7	-2.9	-1.4
Borxhi Publik (përqind e PBB-së)	66.9	64.9	63.7	75.1	75.4	74.9
Borxhi publik dhe i garantuar (përqind e PBB-së)	71.9	69.5	67.9	77.4	77.3	76.6
Prej të cilit: I Jashtëm (përqind e PBB-së)	31.6	30.4	29.1	34.1	32.7	30.3
Eksportet e mallrave (përqind e PBB-së)	6.9	7.7	6.6	6.1	6.2	6.2
Importi i mallrave (përqind e PBB-së)	31.3	30.1	29.7	29.1	29.2	29.1
Eksportet neto të shërbimeve (përqind e PBB-së)	9.4	8.7	9.3	8.1	8.9	11.2
Bilanci tregtar (përqind e PBB-së)	-15.1	-13.7	-13.8	-14.8	-14.1	-11.7
Fluksi hyrës i remitançave, neto (përqind e PBB-së)	5.5	5.2	5.2	5.2	4.8	4.8
Bilanci i llogarisë korrente (përqind e PBB-së)	-7.5	-6.8	-8.0	-8.9	-7.7	-6.4
Flukset hyrëse neto të Investimeve të huaja direkte (përqind e PBB-së)	8.6	8.0	7.6	6.9	6.2	7.7
Borxhi i jashtëm (përqind e PBB-së)	68.8	65.2	60.5	65.0	60.9	55.4
Rritja reale e kredimit privat (përqind, mesatare e periudhës)	-2.3	-3.0	1.5	5.2	n.a.	n.a.
Kreditë me probleme (përqind e totalit të kredive, fundi i periudhës)	13.2	11.1	8.4	8.1	n.a.	n.a.
Norma e papunësisë (përqind, mesatare e periudhës)	13.7	12.3	11.5	11.7	n.a.	n.a.
Norma e papunësisë e të rinjve (përqind, mesatare e periudhës)	25.9	23.1	21.5	20.9	n.a.	n.a.
Shkalla e pjesëmarrjes në forcën e punës (përqind, mesatare e periudhës)	58.3	59.4	60.4	59.5	n.a.	n.a.
PBB për frymë, PPP (Dollarë ndërkombëtar korrent)	11,693	15,101	15,433	n.a.	n.a.	n.a.

Burimet: Autoritetet e Vendit, Vlerësime dhe parashikime të Bankës Botërore.

Shënim: Norma e papunësisë për të rinjtë i referohet forcës së punës në grupmoshën 15-29 vjeç. Kontributi i diferencës statistikore është ndarë në raportin 80 përqind me 20 përqind, respektivisht midis konsumit dhe investimeve ndryshimi në inventar është përfshirë tek investimet.

